

KONTRATË

MBI ‘‘THEMELIMIN E SHOQËRISË SË THJESHTË’’

‘‘Pixie’’

Sot, me datë 25/03/2024, në Shkodër, Shqipëri, personi i mëposhtëm:

Z. Andrea Nepi, shtetas italian, lindur më 25/03/1983 banues në Shkodër, lindur ne Milano (Itali) me numër **I33325003O**, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar;

dhe **Znj.Edona Abdurrahmani**, shtetase shqipëtare, lindur me 30/06/1992 lindur dhe banuese në Shkodër, mbajtës i letërnjoftim me numër **J25630103M**, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, vendosën të themelojnë një shoqëri të thjeshtë në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqiperisë dhe me dispozitat në vijim:

TË PËRGJITHSHME

Ky akt rregullon pozitën juridike, marrëdhëniet e anetarëve themelues, marrëdhëniet e organeve të saj, llojin e partneritetit, kohëzgjatjen e veprimtarisë së shoqërisë së thjeshtë, duke u bazuar në legjislacionin shqiptar në fuqi që rregullon marrëdhëniet juridiko-civile.

NENI 1

Emri i shoqërisë së thjeshtë është ‘‘ **Pixie** ’’, këtu e më poshtë e quajtur ‘‘**Shoqëria**’’. Shoqëria është person juridik privat.

Shoqëria udhëhiqet nga parimet e ekonomisë së tregut dhe ka për qëllim, mes të tjerave, fitimin. Shoqëria organizohet në formën e shoqërisë së thjeshtë. Veprimtaria e saj i nënshtrohet dispozitave të kësaj kontrate themelimi dhe të legjislacionit në fuqi.

NENI 2

Adresa e shoqërisë

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresen: **Ndertesa me nr. Pasurie 54;H.1, Rruga Musa Juka, zona kadastrale 8594, Shkoder 4001.**

Shoqëria mund të hapë degë përfaqësimi në qytetet e tjera të Republikës së Shqipërisë dhe/ose jashtë saj.

NENI 3

Objekti

Objekti i shoqërisë do të jetë;

Krijim website dhe zhvillim software. Shërbime të tjera në fushën e IT.

NENI 4

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një periudhë të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në QKB.

NENI 5

Kapitali Themelor dhe Ortakët


Kapitali i Shoqërisë është 10 000 Lekë (dhjetemije lek).

Kapitali është shlyer nga anëtarët themelues në raportet e mëposhtme;

-nga **Z. Andrea Nepi**, 80% e kapitalit, me 1 kuotë, 8 000 lek kapital

-nga **Znj.Edona Abdurrahmani**, 20% e kapitalit, me 1 kuotë, 2 000 lek kapital

Kapitali themelor është nënshkruar dhe shlyer plotësisht me kontribute në para nga Anëtarët me themelimin e Shoqërisë.



NENI 6
Asambleja e Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme është organi me i lartë vendim-marrës i Shoqërisë. Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me dispozitat e kësaj Kontrate, janë të detyrueshme për të gjithë Anëtarët, pavarësisht janë apo jo të pranishëm në mbledhje, janë apo jo dakord me këto vendime.

NENI 7
Administratori

Shoqëria administrohet nga një ose me shumë administrator/e, i/të emeruar nga Asambleja e Përgjithshme.

Administratori i parë i Shoqërisë është:

Z. Andrea Nepi, shtetas italian, lindur më 25/03/1983 banues në Shkodër, lindur ne Milano (Itali) me numër I33325003O, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar;

Mandati i Administratorit është për një periudhe prej 5 (pesë) vitesh, nga data **25.03.2024 – 25.03.2029**. I rinovueshem, dhe, nese është rasti, vazhdon deri në vendimin e ardhshëm të Asamblesë së Përgjithshme që do të marrë vendim në lidhje me rinovimin e mandatit të tij apo emërimin e administratorit të ri. Shoqëria përfaqësohet ndaj të tretëve nga Administratori i cili është përgjegjës personalisht për shkelje të ligjit, të Satutit dhe për gabimet e kryera gjatë administrimit të Shoqërisë.



NENI 8
Viti Financiar

Viti financiar fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor të cdo viti kalendarik. Në përfundim të vitit kalendarik, Administratori harton pasqyrat financiare të Shoqërisë në përputhje me ligjet në fuqi.


Përfundimisht, viti i parë financiar fillon me regjistrimin e Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe përfundon me 31 Dhjetor 2023.

NENI 9
Të ndryshme

Kjo Kontratë Themelimi është hartuar në 4 kopje origjinale në gjuhën shqipe me të njëjten vlerë secila.

ORTAKËT E SHOQËRISË

Andrea Nepi

Andrea Nepi 

Edona Abdurrahmani

EDONA ABDURRAHMANI

